



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Kodi i lëndës: INF 162

Lënda: Principet bazë të Infermierisë II

PROGRAMI I LËNDËS								
Principet bazë të Infermierisë II								
Titullari / pedagogu i lëndës		Enkelejd Mehilli, <i>PhD në Politika Shëndetësore</i>						
Ngarkesa:	ECTS	Orë mësimi në auditor					Studim individual	Totali
		Leksion	Seminar	Lab	Praktikë	Projekt klinik		
	8	45	0	45	0	0	110	200
Tipologjia e lëndës		Disiplinë karakterizuese						
Vitiakademik /Semestri kur zhvillohet lënda		Viti I, Semestri II						
Lloji i lëndës		E detyruar						
Programi i studimit		Bachelor në Infermieri Mami.						
Kodi i lëndës		INF 162						
Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës		<a href="mailto:mehilli@univlora.edu.al">mehilli@univlora.edu.al</a> , <a href="mailto:ekicaj@yahoo.it">ekicaj@yahoo.it</a>						

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Përmbledhja	<p>Principet bazë të Infermierisë është një lëndë formuese profesionale, e bazuar në tematikat komplekse që shtjellon si procedurat infermiore bazë, principet bazë të kujdesjeve infermiore, dokumentacioni infermior. Në këtë modul futen dhe teknikat infermiore e cila në vitin e parë synon ti njohë studentët dhe tiftesojë ne aplikimin e tyre pranë manekinit për të kaluar në vitin pasardhës në shërbimin spitalor dhe realizimin e teknikave infermiore nën kujdesjen e personelit infermior dhe pedagogut të praktikës tek pacienti i hospitalizuar.</p>
Objektivat e lëndës	<p>Në përfundim të këtij kursi studentët do të kenë njohuri në drejtim të</p> <ul style="list-style-type: none"><li>▪ Aplikimit të Proçesit Infermior gjatë përkujdesje shëndetësore tek pacientët me probleme aktuale apo dhe potenciale shëndetësore.</li><li>▪ Aplikimit të teknikave më të mira të komunikimit me pacientët</li><li>▪ Aplikimit të promovimit shëndetësor dhe teknikave parandaluese të dëmtimit të shëndetit të pacientit.</li><li>▪ Kujdesit shëndetësor në eliminimin urinar dhe intestinal.</li><li>▪ Kujdesit gjatë ushqyerjes së pacientit.</li><li>▪ Kujdesit ndaj plagëve dhe dekubituseve.</li><li>▪ Administrimit të medikamenteve dhe rrugëve të ndryshme të administrimit të medikamenteve.</li><li>▪ Eliminimit të rrezikut gjatë ushtrimit të profesionit si infermier.</li><li>▪ Ndhimës së shpejtë dhe reanimacionit zemër mushkri.</li></ul>
Rezultatet e të nxënit	<p>Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>☞ Të realizojnë përkujdesjet infermiore në bazë të mendimit kritik.</li><li>☞ Të realizojnë administrimin e medikamenteve.</li></ul>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

	<ul style="list-style-type: none"><li>☛ Të njohin bazat fiziologjike të përkujdesjeve infermierore.</li><li>☛ Të realizojnë teknikat e dhënies së ndihmës së parë.</li><li>☛ Të realizojnë kujdesin infermieror në eliminimin urinar dhe intestinal.</li><li>☛ Të kujdesen për një plagë të pastër, të kontaminuar, të infektuar apo dhe për një dekubitus</li></ul>
--	--

### KONCEPTET THEMELORE

1. Bazat fiziologjike të kujdesjeve infermierore
2. Përkujdesjet shëndetësore gjatë gjithë jetës. Promocioni shëndetësor dhe parandalimi.
3. Administrimi i medikamenteve risqet profesionale në ambjentet spitalore.
4. Ndihma infermierore në situatat emergjente

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
I.	<b>Tema 1</b> – Testet dhe procedurat diagnostikuese. <i>Personeli infermieror ka një rol të rëndësishëm në realizimin e testeve diagnostikuese dhe laboratorike. Kjo ndihmë konsiston që në periudhën parapërgatitore, gjatë realizimit të saj dhe pas realizimit të metodave diagnostikuese.</i> <b>Tema 2</b> - Shëndeti dhe mirëqënia. Modelet e shëndetit. Faktorët që ndikojnë në shëndetin e individit. Promocioni shëndetësor, edukimi dhe parandalimi i patologjive. Nivelet përkujdesëse <i>Modelet e shëndetit ofrojnë mundësinë e të kuptuarit lidhjen midis konceptit të shëndetit, mirëqënies dhe sëmundjes. Konceptet e promocionit shëndetësor, mirëqënies dhe parandalimit të sëmundjeve janë shumë të lidhura me njëra tjetrën në praktikën e përkujdesjeve shëndetësore. Të gjitha këto janë të fokusuar në të ardhmen, diferenca midis tyre qëndron tek motivacioni dhe objektivat</i> <b>Tema 3</b> - Nevojat humane bazë. <i>Nevojat humane bazë sipas Virginia Henderson dhe Masloë.</i>	<i>fq.214 - 220</i>  <i>fq.26-32</i>  <i>fq.61-65</i>	Leksion 1 orë  Leksion 1 orë  Leksion 1 orë
	<b>Laborator 1</b> - Marrja e një kampioni gjaku venoz për ekzaminim. <b>Laborator 2</b> - Marrja e një kampioni gjaku venoz për ekzaminim. <b>Laborator 3</b> - Marrja e gjakut për ekzaminim me sistem vacutainer.		<i>Laborator 3 orë</i>
	<b>II.</b>	<b>Tema 4 - 5</b> – Komunikimi human (2 orë) <i>Komunikimi si një marrëdhënie terapeutike, metodat e komunikimit. Teknikat bazë të komunikimit.</i> <b>Tema 6</b> - Aktiviteti dhe ushtrimet fizike. <i>Aktiviteti i rregullt fizik dhe ushtrimet fizike, parimet për lëvizjen dhe teknikën e pozicionimit të pacientit. Njohuritë bazë.</i> <b>Laborator 4 – 5</b> - Mbledhja e një kampioni ekspektoranti. EKG, përdorimi i tamponëve për ekzaminim kultural <b>Laborator 6</b> - Marrja e urinës për ekzaminim laboratorik.	<i>fq.69-79</i>  <i>fq.233-239</i>
<b>III.</b>	<b>Tema 7</b> – Procesi infermieror në aktivitet dhe ushtrimet fizike. <i>Ndihma infermierore e bazuar në 5 etapat e procesit infermieror.</i> <b>Tema 8 - 9</b> –Higjena dhe kujdesi për pacientin. Procesi infermieror gjatë kujdesit për higjenën e pacientit <i>Të asistosh në realizimin e higjienës individuale do të thotë për</i>	<i>fq.239-246</i>  <i>fq.250-258</i>	Leksion 1 orë  Leksion 2 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>infermierin jo vetëm të mëndojë për karakteristikat e ndërhyrjes që duhet të realizojë por dhe për nënkuptimet që mund të vijnë si rezultat i kontaktit, veprim ky i nevojshëm për realizimin e higjienës së pacientit.</i></p> <p><b>Laborator 7</b> - Ecja bashkë me pacientin <b>Laborator 8</b> - Higjena parciale dhe totale e pacientit. <b>Laborator 9</b> - Higjena parciale e pacientit</p>		Laborator 3 orë
IV.	<p><b>Tema 10 - 11</b> – Ushqyerja në faza të ndryshme të jetës. Asistenca infermiere në ushqyerje <i>Ushqyerja në faza të ndryshme fiziologjike apo dhe në situata patologjike duke u bazuar në principet e përkujdesjeve infermiere.</i></p> <p><b>Tema 12</b>–Eliminimi urinar. <i>Ndihma ndaj pacientit në drejtim të eliminimit urinar duke respektuar principet e përkujdesjeve infermiere.</i></p> <p><b>Laborator 10</b> - Asistenca në ushqyerjen e pacientit <b>Laborator 11</b> - Inserimi i sondës nasogastrike. <b>Laborator 12</b> - Ushqyerja e pacientit me sondë nazogastrike</p>	<p><i>fq.291-301</i></p> <p><i>fq.309-315</i></p>	<p>Leksion 2 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Laborator 3 orë</p>
V.	<p><b>Tema 13</b> – Eliminimi intestinal. <i>Ndihma ndaj pacientit në drejtim të eliminimit intestinal duke respektuar principet e përkujdesjeve infermiere</i></p> <p><b>Tema 14</b> –Mobiliteti. Asistenca infermiere ne mobilitet. <i>Lëvizja lind si një nevojë e pandarë e njeriut që e shtyn atë të plotësojë çfarëdo dëshirë të tij apo çdo qëllim që kërkon të arrij.</i></p> <p><b>Tema 15</b>–Pozicionet e pacientit në shtrat. <i>Pozicionet e pacientit në shtrat dhe roli i infermierit në ruajtjen korrekte të këtyre pozicioneve</i></p> <p><b>Laborator 13 – 14</b> - Asistenca infermiere në eliminimin urinar: përdorimi i uturakut, inserimi i kateterit urinar të përkohshëm dhe të përhershëm.</p>	<p><i>fq.326-329</i></p> <p><i>fq.336-341</i></p> <p><i>fq.341-345</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Laborator 3 orë</p>
VI.	<p><b>Tema 16 – 17</b> – Imobiliteti. Asistenca infermiere në imobilitet <i>Imobiliteti shoqërohet me ndryshme të dukshme në shumë sisteme të organizmit human për këtë nevojitet njohja prej personelit infermior të këtyre ndryshimeve dhe ndihmën që duhet të japi tek pacienti në parandalimine tyre apo dhe kujdesje</i></p> <p><b>Tema 18</b> - Plagët. Karakteristikat, klasifikimi. Procesi i shërimit. <i>Njohja e plagëve, karakteristikave ndikon në ofrimin e duhur të kujdesjeve infermiere..</i></p> <p><b>Laborator 16 – 18</b> -Aplikimi i një klizme pastruese, mjekuese, Sondimi rektal.</p>	<p><i>fq.345-350</i></p> <p><i>fq.377-382</i></p>	<p>Leksion 2 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Laborator 3 orë</p>
VII.	<p><b>Tema 19</b> – Plagët, llojet e shërimit, faktorët që ndikojnë në shërimin e plagëve <i>Shërimi i plagëve është i ndryshëm në varësi të faktorëve që e kane shkaktuar.</i></p>	<p><i>fq.382-384</i></p>	Leksion 1 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><b>Tema 20 - 21</b> -Dekubituse. Kujdesi ndaj tyre <i>Dekubituset janë një dëmtim indor që shkon në nekrozë, që prek lëkurën dhe indin subcutan, dhe në raste të rënda mund të prek muskujt apo dhe kockat. Roli i infermierit është në parandalimin e shfaqjes së tyre tek pacientet e hospitalizuar.</i></p> <p><b>Laborator 19 – 21</b> - Mekanika trupore</p>	<i>fq.385-390</i>	Leksion 2 orë  Laborator 3 orë
III.	<p><b>Tema 22</b> – Dhimbja, perceptimi dhe trajtimi i saj <i>Përkufizimi i dhimbjes, klasifikimi isaj, vlerësimi prej personelit infermieror.</i></p> <p><b>Tema 23 - 24</b> -Kujdesi para një ndërhyrje kirurgjikale. Kujdesi gjatë një ndërhyrje kirurgjikale. <i>Infermieri ka një detyrë të rëndësishme në kujdesjet që i ofrohen pacientit përpara realizmit të ndërhyrjes kirurgjikale dhe gjatë ndërhyrjes kirurgjikale.</i></p> <p><b>Laborator 22</b> - Rehabilitimi fizik <b>Laborator 23</b> - Mjekimi i një plage të infektuar dhe i një plage të pastër, një dekubitusi <b>Laborator 24</b> - Fashaturat. Bandazhimi</p>	<i>fq.416-421</i>  <i>fq.422-430</i>	Leksion 1 orë  Leksion 2 orë  Laborator 3 orë
IX.	<p><b>Tema 25 - 26</b> – Kujdesi infermieror në dhomën e zgjimit të pacientit. Kujdesi postoperator. <i>Përgjegjësia e infermierit është të vëzhgoj nëse ka komplikacione, ndëse pacienti ndjen diskonfort, të ndihmoj në përmirësimin e gjendjes së pacientit dhe monitorimin e vazhdueshëm të tij.</i></p> <p><b>Tema 27</b>–Administrimi i medikamenteve. Përkufizimi, klasifikimi dhe format e medikamenteve <i>Administrimi i mediakmenteve është një detyrë e rëndësishme e personelit infermieror. Infermieri duhet të njohi medikamentet, rrugët e administrimit dhe klasifikimin e medikamenteve.</i></p> <p><b>Laborator 25 – 27</b> -Fashaturat e një plage.</p>	<i>fq.431-438</i>  <i>fq.442-448</i>	Leksion 2 orë  Leksion 1 orë  Laborator 3 orë
X.	<p><b>Tema 28</b> – Administrimi i medikamenteve. Mirëmbajtja, konservimi i medikamenteve dhe medikamenteve stupefacente. Vetitë e medikamenteve <i>Njohja e vetive të medikamenteve dhe kushteve që duhet të plotësohen për ruajtjen e medikamenteve.</i></p> <p><b>Tema 29</b>– Rruga sublinguale e administrimit. Rruga orale e administrimit. <i>Rruga sublinguale, avantazhet dhe disavantazhet. Rruga orale avantazhet disavantazhet.</i></p> <p><b>Tema 30</b>–Rruga rektale e administrimit. Rruga respiratore e administrimit. <i>Administrimi i medikamenteve në rrugë rektale dhe respiratore. Avantazhet dhe disavantazhet e secilës rrugë.</i></p>	<i>fq.448-454</i>  <i>fq.454-456</i>  <i>fq.456-458</i>	Leksion 1 orë  Leksion 1 orë  Leksion 1 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<b>Laborator 28 – 30 - Administrimi i medikamenteve</b>		Laborator 3 orë
XI.	<b>Tema 31</b> – Rrugat cutane të administrimit <i>Administrimi i medikamenteve në rrugë cutane. Avantazhet dhe disavantazhet e saj.</i>	<i>fq.458-459</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 32</b> – Administrimi i medikamenteve në rrugë subcutane <i>Administrimi i medikamenteve në rrugë SC. Avantazhet disavantazhet, zonat e injeksionit.</i>	<i>fq.459-461</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 33</b> –Administrimi i medikamenteve në rrugë intradermike <i>Administrimi i medikamenteve në rrugë ID. Avantazhet disavantazhet, zonat e injeksionit.</i>	<i>fq.461-462</i>	Leksion 1 orë
	<b>Laborator 31 – 33 - Administrimi i medikamenteve</b>		Laborator 3 orë
XII.	<b>Tema 34</b> – Administrimi i medikamenteve në rrugë intramuskulare <i>Administrimi i medikamenteve në rrugë IM. Avantazhet disavantazhet, zonat e injeksionit. Teknika "Z".</i>	<i>fq.462-464</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 35</b> – Administrimi i medikamenteve në rrugë Intravenoze. <i>Administrimi i medikamenteve në rrugë IV. Avantazhet disavantazhet, zonat e injeksionit. Komplikacionet.</i>	<i>fq.464-466</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 36</b> –Terapia endovenoze. <i>Qëllimi i terapisë endovenoze, pse përdoret. Metodatat e administrimit, standartizimi i terapisë endovenoze.</i>	<i>fq.466-472</i>	Leksion 1 orë
	<b>Laborator 34 – 36 - Administrimi i medikamenteve.</b>		Laborator 3 orë
III.	<b>Tema 37</b> – Likuidet, elektrolitet dhe terapia endovenoze. <i>Funksioni i likuideve në organizëm, elektrolitet, karakteristikat e tyre, lëvizja e likuideve në organizëm.</i>	<i>fq.472-479</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 38 - 39</b> – Transfuzioni i gjakut. Kujdesi infermieror në komplikacionet që shfaqen gjatë transfuzionit të gjakut. <i>Grupet e gjakut. Donatorët. Kushtet e terapisë transfuzionale, komplikacionet dhe parandalimi.</i>	<i>fq.509-521</i>	Leksion 2 orë
	<b>Laborator 37 – 39 - Administrimi i medikamenteve</b>		Laborator 3 orë
IV.	<b>Tema 40</b> – Rreziku fizik gjatë ushtrimit të profesionit të infermierit <i>Rrezatimi dhe profesioni i infermierit. Asistenca në rast rrezatimi fizik.</i>	<i>fq.523-529</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 41</b> -Rreziku biologjik gjatë ushtrimit të profesionit. <i>Rrugët e transmetimit të infeksioneve tek personeli infermieror, mbrojtja ndaj rrezikut biologjik.</i>	<i>fq.530- 534</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 42</b> - Rreziku kimik gjatë ushtrimit të profesionit <i>Ekspozimi i personelit infermieror ndaj rrezikut kimik.</i>	<i>fq.535-538</i>	Leksion 1 orë
	<b>Laborator 40 - Administrimi i medikamenteve</b>		Laborator 3 orë
	<b>Laborator 41 – 42 - Realizimi i një transfuzioni gjaku</b>		
XV.	<b>Tema 43</b> – Incidentet tek personeli infermieror <i>Incidentet gjatë ushtrimit të profesionit dhe metodatat për parandalimin e tyre</i>	<i>fq.538-542</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 44 - 45</b> – Ndihma në situatat emergjente <i>Ndihma e përgjithshme në ndërhyrjet e emergjencës, reanimacioni</i>	<i>fq.543-550</i>	Leksion 2 orë





REPUBLICA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<i>kardiopulmonar.</i> <b>Laborator 43 – 45</b> - Reanimacioni zemër – mushkri tek adulti dhe neonati		<i>Laborator 3 orë</i>

**FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE**

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE						
<b>FREKUENTIMI:</b>	<p>Kërkohej një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e laboratorit janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e laboratorit në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhë dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit).</p> <p>Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studentit humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.</p>					
<b>Mënyra e vlerësimit</b>	<i>Forma e vlerësimit</i>	<i>Koha e vlerësimit</i>	<i>Temat mësimore që do vlerësohen</i>	<i>Pikët maksimale</i>	<i>Forma e testimit të njohurive</i>	<i>Përmbajtja e testimit</i>
	Provimi I	Java 7/8	1-15 leksione 1-5 temat e laboratorit	30 pikë	Provimi me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Provimi përfundimtar	Fundi i semestrit	16 – 45 leksionet 6-15 temat e laboratorit	60 pikë	Provimi me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Vlerësim i vazhduar*	Java 14/15	Temat e laboratorit	10 pikë	Realizim procedurash në laborator	Demonstrim procedure
	*Vlerësim i vazhduar - Do të realizohet prej pedagogut të laboratorit për gjatë gjithë semestrit. Studentët do të demonstrojnë në mënyrë periodike teknikat infermirore pranë manekinit.					
	Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare do të jetë si më poshtë:					
	40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë
5	6	7	8	9	10	

**LITERATURA**

<b>Literatura bazë e detyruar</b>	“ <b>Fondamental of Nursing</b> ” Edition 8, 2012. Publisher Elsevier Health Science ISBN – 13 9780323079334 (Përkthyer dhe përgatitur nga Emirjona Kiçaj, Denada Selfo, Rudina Cercizaj, Rezarta Lalo dhe Alida Ramaj)
<b>Literatura e rekomanduar</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Proçedurat dhe teknikat Infermirore” E. Kicaj, R. Cercizaj, R. Lalo, A. Ramaj 2010 (FSHP-UV)</li> <li>○ Principet bazë të Infermierisë’ A.Ramaj, E. Kiçaj 2011</li> <li>○ “Infermieri dhe administrimi i medikamenteve” A. Ramaj, E. Kicaj 2011</li> <li>○ “Basic Nursing – Foundations of Skills &amp; Concepts” L.Ëhite, K.M.Campell</li> </ul>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

2002

**VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS**

<b>Dispozita:</b>	Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregojnë interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjatë procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuara.
<b>Vonesat</b>	Vonesat në лекsione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.
<b>Sjellja profesionale e studentit</b>	Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimin, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimin, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijance nga këto rregulla, do të ketë penaltete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit dhe të Fakultetit të Shëndetit Publik.
<b>Integriteti akademik dhe e drejta e autorit</b>	Çdo test apo punë me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në лекsion abstraksione apo analiza origjinale dhe në pamundësi, të ë gjithnjë burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzjerjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.